

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5679
E premte, 18 janar 2019
çmimi 0.40 €

Greva në arsim vazhdon

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**MJEKË NGA SUECIA OPEROJNË
PACIENTË NË QKUK** F.7



**VËLLEZËRIT GËRVALLA
DHE KADRI ZEKA DHANË
KONTRIBUT TË SHQAR PËR
RRITJEN E NDËRGJEGJES
KOMBËTARE** F.7

**PUTINI: MBËSHITESIM
ARRITJEN E NJË MARRËVESHJE
KOSOVË-SERBI SIPAS
REZOLUTËS 1244** F.2

EKONOMI

**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA
GRANT PËR RRUGËN
KIJEVË - ZAHAQ** F.9

**BIZNESET TË INFORMOHEN MË
SHUMË PËR PRONËSINË
INTELEKTUALE** F.9

KULTURË

**HAPET ZYRA PËR PROGRAMIN
'EVROPA KREATIVE'** F.6



SPORT

**BEQIRI TREGON PENGUN
SI FUTBOLLIST DHE ËNDRRËN
SI GJYQAR** F.20

FLET PËR "EPOKËN E RE", AHMET ISUFI

Të shtohen masat ndaj Serbisë

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet t'i shtojë masat ndaj Serbisë e jo ta heqë taksën prej 100 përqindësh për mallrat serbe që ka vënë që rrethe dy muaj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se taksë duhet të qëndrojë pavarësisht prej presionit amerikan ndaj Kosovës. Isufi ka deklaruar se kjo taksë nuk mund ta rrëzojë Qeverinë e Kosovës, as t'i rrezikojë raportet e mira miqësore të Kosovës me Amerikën. Sipas tij, Qeveria do ta çojë mandatin deri në fund



Haradinaj dhe Hahn fokusohen në agjendën evropiane, s'e përmendin taksën

Kosova ka shënuar përparim në agjendën evropiane dhe pret vendim të shpejtë për liberalizimin e vizave. Kështu ka thënë të enjten kryeministri Ramush Haradinaj pas takimit me komisionarin e BE-së për Zgjerim dhe Fqinjësi, Johannes Hahn. Ndonëse në këtë takim është diskutuar edhe për taksën ndaj produkteve serbe, as Haradinaj e as Hahn nuk e kanë përmendur këtë çështje në deklaratimet e publikuara në rrjetet sociale. Taksë nuk është përmendur as në



komunikatën e Qeverisë. Megjithatë, në një deklaratim para takimit me Hahnin, kryeministri ka thënë se taksë 100 për qind nuk do të hiqet



**Banka
Botërore,
mision
identifikues
për projekte
investive në
ujësjellësin e
Prishtinës**

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, të enjten ka qëndruar për vizitë zyrtare në Beograd

Putini: Mbështesim arritjen e një marrëveshjeje Kosovë - Serbi sipas Rezolutës 1244

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka thënë të enjten në Beograd se qëndrimi i Rusisë është i njohur dhe pajtohem se është e domosdoshme arritja e marrëveshjes reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në bazë të Rezolutës 1244 të OKB-së



BEOGRAD, 17 JANAR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se Rusia pajtohet që Beogradi dhe Prishtina të arrijnë një marrëveshje të pranueshme reciproke në përputhje me Rezolutën 1244. Ai tha se autoritetet në Prishtinë morën disa hapa së fundi, siç është formimi i Ushtrisë së Kosovës, e cila, siç tha, është shkelje e Rezolutës 1244. "Rusia ndan shqetësimin me udhëheqjen dhe popullin serb se këto veprime të papërgjegjshme mund ta destabilizojnë Ballkanin", shtoi Putini. "Qëndrimi i Rusisë është i njohur dhe pajtohem se është e domosdoshme arritja e marrëveshjes reciproke në bazë të rezolutës 1244 të OKB-së", ka thënë Putini në konferencën me gazetarë pas takimit me presidentin serb Aleksandar Vuçiq. Ai në konferencën e përbashkët për gazetarë me homologun serb Aleksandar Vuçiq ka thënë se Rusia, ashtu si edhe Serbia, është e interesuar që situata në Ballkan të jetë stabile dhe e sigurt. Duke përsëritur se ai nuk e sheh një zgjidhje të afërt në perspektivë

ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, presidenti serb Aleksandar Vuçiq tha se për çdo zgjidhje do të konsultohet me Putinin. "Serbia është gjithmonë e gatshme për negociatë dhe kompromis, por nuk pajtohet me poshtërimin", tha presidenti Vuçiq. Të njëjtin qëndrim ai tha se ia ka shprehur edhe homologut të tij rus kur kanë biseduar për Kosovën. Ai tha se e ka njoftuar presidentin rus me gjithë atë çfarë po ndodh në Kosovë për, siç tha, "tarifën ndaj mallrave nga Serbia të vendosur nga Prishtina dhe formimin e Ushtrisë së Kosovës në kundërshtim me Rezolutën 1244". "Morëm mbështetje të konsiderueshme nga Putini", tha Vuçiq. Presidenti i Rusisë udhëheq vizitën e një delegacioni të lartë shtetëror rus në Serbi. Më të arritur në Beograd, Putini është pritur në aeroportin "Nikola Tesla" nga presidenti Vuçiq. "Shpresoj se këtu do të ndiheni si në shtëpinë tuaj", i tha presidenti serb homologut të vet rus në fillim

të pritjes shtetërore. Vuçiqi e falënderoi Putinin për "mundin, kohën, respektin dhe dashurinë për zhvillimin e raporteve serbo-ruse". Ai, gjithashtu, e falënderoi Putinin për mbështetjen në mbrojtjen e integritetit territorial të Serbisë. "Rusia gjithmonë mund të llogarisë se e ka një aleat në Serbi", tha Vuçiq. Ndërkaq, presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, në fillim të takimit tha se "jam shumë i lumtur që kam rastin ta vizitoj Serbinë miqësore, vëllazërore dhe të flas për bashkëpunimin". Paraprakisht të dy presidentët kanë vendosur kurora në memorialin "Varrezat e Çlirimtarëve" në

Beograd. Shkëmbimi i dokumenteve dypalëshe të nënshkruara do të mbahet në prani të dy krerëve të shtetit dhe më pas ceremonia e dekorimit me Urdhrin e "Aleksandër Nevski" të presidentit të Serbisë nga ana e Vladimir Putinit. Kjo vizitë e Putinit nga ana e Serbisë, por edhe disa qarqe ndërkombëtare, është parë si një vizitë e rëndësishme politike në një kohë kur ekziston një mundësi në rritje e angazhimit të drejtpërdrejtë të fuqive kryesore në botë për zgjidhjen e çështjes së raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Para se të nisej për në Serbi, presidenti rus Vladimir Putin ka

deklaruar se ShBA-ja është duke destabilizuar Ballkanin duke treguar "rol dominues" në këtë rajon. Komentet e presidentit rus janë publikuar edhe në faqen zyrtare të Kremlinit. Në deklaratat e tij është theksuar edhe një herë lidhja e ngushtë historike e Moskës me Serbinë si dhe paralajmërimi për ndikimin perëndimor. Komentet e tij kanë qenë edhe në kundërshtim me paralajmërimet nga Uashingtoni dhe nga disa vende evropiane që janë të shqetësuara për tentimet e Rusisë që ta destabilizojë rajonin, duke përfshirë Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinën dhe Maqedoninë.

Ministrat betohen para presidentit Ilir Meta



TIRANË, 17 JANAR - Ministrat e rinj të kabinetit qeveritar u betuan para presidentit Ilir Meta. Emrat e rinj janë plot gjallëri, sidomos femrat ministre dukeshin plot sharmë. Presidencën gjallëronte të enjten dhe mori pamjen e një parade modelesh. Kryeministri ka përzgjedhur femrat më seksi dhe pa komplekse shqiptare për në

kabinetin e ri qeveritar. Ndërkohë mes femrave ministre mbeten sikur lundrojnë ministrat Pandeli Majko dhe Ditmir Bushati, ku Majko pret hanxharin në një moment tjetër, kurse Bushati një këmbë e ka në qeveri dhe tjetrën në ikje, sapo ta mbarojë presidencën e OSBE-së. Anëtarët e rinj të kabinetit janë: Erion Braçe, zëvendëskryemi-

nistër, Besa Shahini, ministre e Arsimit, Anila Denaj, ministre e Financave, Belinda Balluku, ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, Elva Margariti, ministre e Kulturës, Elisa Spiropali, ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Eduard Shali, ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Blendi Çuçi, ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Basha: Qeveria ka rënë, udhëheqim protestat qytetare

TIRANË, 17 JANAR - Pas takimit zyrtar me ministrin Bushati, ministri i Jashtëm i Mbretërisë së Holandës, Stef Blok, është ndalur edhe në selinë e Partisë Demokratike për t'u takuar me kreun e opozitës, Lulzim

Basha. Ky i fundit, në një deklaratë për mediet në përfundim të takimit me politikanin holandez, tha se në Shqipëri nuk ekziston modeli evropian dhe demokratik i qeverisjes. "Këtu një grup oligarkësh kon-

trollojnë të gjitha paratë e shqiptarëve. Opozita vendosi mbrëmjen e së mërkurës që t'i udhëheqë protestat qytetare. Ndaj u bëj thirrje qytetarëve që të bashkohen të gjithë për t'i dhënë fund fasadës së Edi

Ramës. Kjo qeveri ka rënë sepse përfaqëson vetëm një interes fasadë të kryeministrit", tha Basha. Kryetari i opozitës deklaroi në fund se sezoni i protestave që do të nisë do të jetë një mundësi për t'u hapur me njerëzit.



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim komisionarin e Bashkimit Evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi, Johannes Hahn

Haradinaj dhe Hahni fokusohen në agjendën evropiane, s'e përmendin taksën

Kosova ka shënuar përparim në agjendën evropiane dhe pret vendim të shpejtë për liberalizimin e vizave. Kështu ka thënë të enjten kryeministri Ramush Haradinaj pas takimit me komisionarin e BE-së për Zgjerim dhe Fqinjësi, Johannes Hahn. Ndonëse në këtë takim është diskutuar edhe për taksën ndaj produkteve serbe, as Haradinaj e as Hahni nuk e kanë përmendur këtë çështje në deklaratimet e publikuara në rrjetet sociale. Taksa nuk është përmendur as në komunikatën e Qeverisë. Megjithatë, në një deklaram para takimit me Hahnin, kryeministri ka thënë se taksa 100 për qind nuk do të hiqet



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 17 JANAR - Komisionari i Bashkimit Evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi, Johannes Hahn, të enjten ka qëndruar në Prishtinë, ku është pritur në takim nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike dhe ekonomike në vend, për agjendën e reformave evropiane dhe për forcimin e sundimit të rendit dhe të ligjit. Kryeministri Haradinaj e ka njoftuar komisionarin Hahn me proceset nëpër të cilat po kalon vendi, duke theksuar se Kosova mbetet plotësisht e vendosur për të qenë anëtare e Bashkimit Evropian. Ai ka thënë se Kosova ka shënuar progres në agjendën evropiane dhe pas përmbushjes në tërësi të kriterëve për liberalizim pret një vendim të shpejtë për heqjen e vizave. "Në takim me komisionarin e BE-së për Zgjerim, Johannes Hahn, ritheksova se pozicioni i Kosovës është i palëkundur në rrugën e integritimit drejt BE-së. Në këtë drejtim kemi shënuar për-

parim në agjendën evropiane dhe pas përmbushjes në tërësi të kriterëve për liberalizim, presim vendim të shpejtë që të na njihet e drejta e lëvizjes së lirë", ka deklaruar Haradinaj.

Sa i përket çështjes së vizave, kryeministri Haradinaj ka shprehur edhe një herë zhgënjimin ndaj BE-së në raport me Kosovën, duke thënë se, pavarësisht prej përmbushjes së kriterëve të përcaktuara, Kosova mbetet vendi i vetëm me regjim të vizave. "Liberalizimi i vizave është domosdoshmëri për qytetarët dhe bizneset e Kosovës. Të rinjtë tanë meritojnë të lëvizin lirshëm sikurse moshatarët e tyre nga e gjitha bota", është shprehur kryeministri Haradinaj. Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka shprehur përkushtimin e Qeverisë për përmbushjen ERA2, për të cilin Qeveria është duke punuar intensivisht për avancimin e saj.

Sipas komunikatës së lëshuar nga Zyra për Informim e kryeministrit, në këtë takim është biseduar edhe për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë për të cilin kryeministri ka shprehur qëndrimin e Kosovës

për një marrëveshje finale gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme. Po sipas komunikatës, në këtë takim është folur edhe për zhvillimin ekonomik në vend dhe për hapat që ka ndërmarrë Qeveria për përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe për tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Ndërsa komisionari i BE-së për Zgjerim, Johannes Hahn, pas përfundimit të takimit me kryeministrin Ramush Haradinaj në Prishtinë, nëpërmjet një statusi në llogarinë e vet në "Twitter" ka treguar se për çfarë kanë diskutuar. "Vizita e parë e vitit 2019 në

rajon. Pata një diskutim të mirë dhe të hapur me kryeministrin Ramush Haradinaj dhe me ministrat. Duke shpresuar të punojmë ngushtë për të gjitha çështjet e hapura këtë vit, kështu që Kosova të mund të avancojë në rrugën drejt BE-së", ka shkruar Johannes Hahn.

Ndonëse as Haradinaj dhe as Hahni nuk e kanë përmendur fare në statuset e tyre taksën ndaj produkteve serbe, gazeta ka mësuar nga burimet brenda kabinetit qeveritar se në takimin e së enjtes në mes të kryeministrit Haradinaj dhe komisionarit Hahn është diskutuar edhe për çështjen e

taksës ndaj Serbisë.

Bazuar edhe në një deklaratë të kryeministrit Haradinaj para takimit të enjten, tarifa doganore, të cilën Qeveria e Kosovës ua ka vënë produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, ka qenë tema qendrore e diskutimeve. "Kosova ka një agjendë me BE-në për liberalizimin e vizave dhe ne i kemi përmbushur të gjitha kushtet. Tani ka lindur edhe një temë e re. Kjo është taksa që ndërlidhet me njohjen nga Serbia. E mirëpresim çdo sugjerim, çdo këshillë që të bisedojmë me komisionarin Hahn", është shprehur Haradinaj.

Ministri Bytyqi ofron mbështetje për infrastrukturën e UP-së

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka mbajtur të enjten një takim me Këshillin Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me anëtarët e të cilin ka biseduar rreth problemeve që kanë për mungesë të infrastrukturës, për nevojën për ndërtimin e objekteve të reja, si dhe për riparimet e nevojshme të objekteve të vjetra. Ministri Bytyqi ka shprehur gatishmërinë që të ofrojë mbështetje për plotësimin e infrastrukturës, për tejkalimin e vështirësive që kanë në këtë drejtim, por ka theksuar edhe nevojën që kërkesat të qartësohen, të adresohen problemet dhe të

angazhohemi së bashku, që t'i bëjmë zgjidhjet e duhura brenda mundësive. Në këtë kontekst, ministri Bytyqi ka theksuar gatishmërinë e MASH-it që së bashku me përfaqësues të UP-së të angazhohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo të konflikteve që kanë me Komunën e Prishtinës lidhur me shfrytëzimin e hapësirave universitare. Në këtë takim, veç të tjerash, u bisedua konkretisht për fakultetet të cilat kanë nevojë më të madhe për zgjerim të infrastrukturës universitare dhe për objektet ekzistuese të disa fakulteteve që kanë nevojë që sa më shpejt të intervenohet në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese.



Flet për "Epokën e re", Ahmet Isufi

Të shtohen masat ndaj

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet t'i shtojë masat ndaj Serbisë e jo ta heqë taksën prej 100 përqindësh për mallrat serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se taksa duhet të qëndrojë pavarësisht prej presionit amerikan ndaj Kosovës. Sipas tij, kjo nuk mund t'i rrezikojë raportet e mira Kosovë-ShBA. Isufi ka deklaruar se kjo taksë nuk mund ta rrëzojë Qeverinë e Kosovës. Sipas tij, Qeveria do ta çojë mandatin deri në fund

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 JANAR - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, kategorikisht është shprehur kundër heqjes së taksës prej 100 përqindësh për mallrat serbe. Pavarësisht prej presionit amerikan, ai ka thënë se taksa nuk duhet të hiqet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmeti ka thënë se duhet të shtohen sanksionet ndaj Serbisë. "Taksa i është vendosur Serbisë si kundërvënie të politikës së saj destruktive ndaj Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Pra, kjo taksë nuk ka të bëjë me të tjerët përveç me Serbinë e cila nuk po e ndryshon politikën karshi Kosovës. Prandaj, taksa mbetet në fuqi, madje duhet të shtohen edhe sanksionet e tjera ndaj Serbisë", ka thënë Isufi. Ai ka vlerësuar se kjo taksë nuk mund t'i rrezikojë raportet ShBA - Kosovë. "Raportet e Kosovës me ShBA-në janë historike dhe tradicionale. Këto raporte nuk rrezikohen sepse ne gjithmonë kemi treguar gatishmërinë që me ShBA-në të kemi bashkëpunim të jashtëzakonshëm. Shqiptarët dhe Kosova me të drejtë konsiderohen miqtë më të mëdhenj të amerikanëve", është shprehur ai.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së është shprehur i bindur se për shkak të kësaj takse nuk bie Qeveria. Sipas Isufit, Qeverinë aktuale vetëm e forcojnë veprimet që e fuqizojnë subjektivitetin e Republikës së Kosovës. "Nuk bie Qeveria për shkak të taksës, përkundrazi Qeveria forcohet duke e forcuar subjektivitetin e Kosovës. Normalisht se një Qeveri çfarë është kjo tani e cila po merr vendime të mëdha për vendin, meriton ta kryejë mandatin, madje ta garantojë edhe mandatin e ardhshëm qeverisës", ka thënë ai, duke shtuar se kjo Qeveri do ta çojë mandatin deri në fund.



Isufi ka folur edhe për pretendimet e LDK-së se ka pasur një ofertë nga PDK-ja për ta rrëzuar Qeverinë. Sipas tij, qëndrimet e LDK-së janë konfuzë dhe nuk u beson askush. "Zyrtarët e LDK-së çdo ditë po i ndërrojnë deklaratat dhe nuk po mund t'u biem në fije se cila është e vërteta që thonë. Ata kanë deklarata shumë konfuzë. E kanë bërë konfuz edhe opinionin", ka thënë Isufi.

"Epoka e re": Z. Isufi, së fundi është shtuar presioni amerikan ndaj Qeverisë për heqjen e taksës për mallrat serbe. Cili është qëndrimi i AAK-së për këtë çështje?

Isufi: Taksa i është vendosur Serbisë si kundërvënie të politikës së saj destruktive ndaj Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Pra, kjo taksë nuk ka të bëjë me të

tjerët, përveç me Serbinë e cila nuk po e ndryshon politikën karshi Kosovës. Prandaj, taksa mbetet në fuqi, madje duhet të shtohen edhe sanksione të tjera ndaj Serbisë, duke e ditur se Kosova ka nevojë të funksionojë si shtet normal.

"Epoka e re": Çfarë nëse me mosheqjen e taksës rrezikohen raportet e Kosovës me ShBA-në?

Isufi: Raportet e Kosovës me ShBA-në janë historike dhe tradicionale. Këto raporte nuk rrezikohen, sepse ne gjithmonë kemi treguar gatishmërinë që me ShBA-në të kemi bashkëpunim të jashtëzakonshëm. Shqiptarët dhe Kosova me të drejtë konsiderohen si miku më i madh i amerikanëve. Kjo nuk ka të bëjë me politikën ditore, por me një politikë të vazhdueshme.

"Epoka e re": Pas kërkesave të fundit të ShBA-së për këtë çështje, zyrtarët e PDK-së janë treguar më fleksibilë, duke thënë se, nëse taksa rrezikon raportet me ShBA-në, ajo duhet të shqyrtohet. A duhet ta shqyrtojë Qeveria e Kosovës edhe një herë këtë vendim?

Isufi: Çdo çështje e cila ngrihet duhet të shqyrtohet me partnerët qeverisës. Por, sa i përket taksës, koalicioni qeverisës ka të njëjtin qëndrim. Taksa e vendosur nga Qeveria e Kosovës për mallrat serbe nuk hiqet. Pra, koalicioni ka një qëndrim për këtë çështje dhe duhet të vazhdojë në këtë mënyrë.

"Epoka e re": Do të thotë, pavarësisht prej kërkesave që ka ShBA-ja, mendoni se Kosova nuk duhet ta tërheqë taksën?

Isufi: Ne normalisht se kemi në

konsideratë çdo këshillë të miqve tanë, në veçanti të ShBA-së, por ne jemi edhe për mbrojtjen e interesave të përbashkëta kur ato kanë të bëjnë me interesat kombëtare dhe mbrojtjen e tyre.

"Epoka e re": Ka pasur paralajmërim të ndryshme se për shkak të kësaj takse edhe mund të bjerë Qeveria. Besoni se mund të ndodhë një gjë e tillë?

Isufi: Nuk bie Qeveria për shkak të taksës, përkundrazi Qeveria forcohet duke e forcuar subjektivitetin e Kosovës. Normalisht se një Qeveri çfarë është kjo tani e cila po merr vendime të mëdha për vendin, meriton ta kryejë mandatin, madje ta garantojë edhe mandatin e ardhshëm qeverisës.

"Epoka e re": Së fundi kemi pasur disa pretendime të

Serbisë

ditë po i ndërrojnë deklaratat dhe nuk po mund t'u biem në fije se cila është e vërteta që thonë. Prandaj, ata kanë deklarata shumë konfuze. E kanë bërë konfuz edhe opinionin. Deklaratat e tyre janë të paqëndrueshme.

"Epoka e re": Megjithatë, zyrtarët e PDK-së kanë bërë me dije se nuk do të ketë zgjedhje dhe kjo Qeveri do ta vazhdojë mandatin deri në fund. Keni besim në këtë qëndrim të partnerit të koalicionit?
Isufi: Kjo Qeveri meriton ta kryejë mandatin deri në fund për shkak të proceseve që ka Kosova. Po ashtu, mendojmë se me punën e mirë në këtë mandat kjo Qeveri do të garantojë edhe mandate të tjera.

"Epoka e re": Kryesia e Kuvendit të premten do të mbledhet për ta caktuar seancën e parë të sesionit pranveror. Çfarë duhet të ketë prioritet Kuvendi në këtë sesion?

Isufi: Kuvendi i Kosovës në këtë sesion do t'i ketë prioritet projektligjet të cilat janë të domosdoshme të miratohen dhe të amendmentohen në Kuvend për t'i forcuar të gjitha sferat në Kosovë. Po ashtu, edhe projektligjet që kanë të bëjnë me procesin e integritimit evropian duhet të kenë përparësi.


"Epoka e re": Monitoruesit e Kuvendit kanë vlerësuar se në sesionin vjeshtor ky institucion nuk ka punuar sa duhet. Pritini që këtë sesion Kuvendi të jetë më dinamik?

Isufi: Besoj se në këtë sesion Kuvendi i Kosovës do të jetë më dinamik edhe për shkak të proceseve që na presin. Normalisht se presim të shtohet intensiteti i punës për t'i kryer punët që na takojnë.

LDK-së se, gjoja, PDK-ja i është ofruar opozitës për ta rrëzuar Qeverinë. U besoni këtyre pretendimeve?

Isufi: Zyrtarët e LDK-së çdo

TRE RANË, MIJËRA U NGRITËN!



Lulëzim ETEMAJ

37 vjet më parë, më 17 janar 1982, u vranë në Untergruppenbach të Gjermanisë, nga UDB-a jugosllave, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla, tre nga prijësit kryesorë të Lëvizjes Kombëtare Çlirimtare të Kosovës. Vrasja e tre heronjve ndodhi pikërisht në kohën kur ata, duke qenë se vepronin në dy organizata të ndryshme politike kombëtare, ishin në prag të bashkimit në një Lëvizje të përbashkët, e cila për qëllim kryesor e kishte luftën me të gjitha mjetet, politike dhe ushtarake, për statusin e Republikës së Kosovës, si zgjidhje kalimtare drejtë bashkimi me shtetin amë - Shqipërinë, si jetësim i qëllimit kryesor të Lëvizjes Irredentiste Shqiptare të shqiptarëve të mbetur jashtë Shqipërisë, e cila prijës kryesor, jo vetëm shpirtëror, e kishte heroin Adem Demaçi, i cili në këtë kohë po e vuante dënimin e tretë prej 15 vitesh burgim të rëndë.

Vrasja e Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës ishte një nga goditjet më të rënda të Lëvizjes Kombëtare Çlirimtare të Kosovës. Por, në anën tjetër, kjo vrasje, krahas pezmit dhe indinjatës, i dha impulse të reja shumë të fuqishme zgjimit të vetëdijes kombëtare tek shqiptarët dhe angazhimit të tyre, ndërsa për bashkëveprimtarët e Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Jusuf Gërvallës u shndërrua në motiv shtesë dhe në forcë për të arritur një muaj më vonë, më 17 shkurt 1982, gjer tek akti final i bashkimit mbi themelet e vëna nga heronjtë - në Lëvizjen për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ).

12 vite më vonë, më 17 nëntor 1994, pasuesja e LRSSHJ, Lëvizja

Popullore e Kosovës (LPK) e themelon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), me ç'rast u lëshua komunikata e parë ushtarake, ajo me numër 11, lufta e së cilës, falë edhe mbështetjes së aleatëve strategjik të Kombit tonë, ShBA-së dhe partnerëve të tjerë të NATO-s, që ndërhyne edhe me sulme ajrore kundër forcave ushtarake, policore dhe caqeve tjera strategjike të Serbisë, çoi në çlirimin e Kosovës në qershor të vitit 1999 dhe shpalljen e saj shtet i pavarur dhe sovran nga deputetët e Kuvendit më 17 shkurt 2008.

"Tre ranë, me mijëra u ngritën", ky ishte kryeartikulli i numrit 3 i organit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Visave tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVShJ), "Zëri i Kosovës", i botuar pas vrasjes së heronjve, në mars të vitit 1982. Artikulli i paraprindë përkushtimi jetësorë i Jusuf Gërvallës: ".....Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme".

Pas njëzet vitesh qëndrimi në dhe të huaj, Kosovës iu kthyen për t'u riarrosur eshtrat e heronjve të saj Jusuf Gërvalla, Kadri

Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Kosova tashmë ishte e lirë, porse e politizuar skajshmërisht dhe tepër e përcarë politikisht. Pasojat e kësaj përcarjeje politike e Kosovës i detyroi t'i vuajnë edhe heronjtë. Ata që i kishte bashkuar ideali, po ashtu edhe vdekja, që në varret e huaja kishin qëndruar po ashtu pranë e pranë njëri-tjetrit, më 24 shkurt 2002 i ndau politika përcarëse e Kosovës, për t'i varrosur ndaras, Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën në varrezat e fshatit Dubovik (komuna e Deçanit), ndërsa Kadri Zekës në Varrezat e Dëshmorëve në Gjilan. Është koha dhe është obligim i shtetit të Kosovës që ta korrigojnë këtë padrejtësi që u është bërë tre heronjve dhe t'i riarrosë në një varrezë të përbashkët. Riarrosja e eshtrave të tyre pranë heroit Adem Demaçi mund të ishte një nga zgjidhjet e mundshme e cila do të mund t'u siguronte prehje të përbashkët dhe qetësi.

Rolin kryesor në këtë ribashkim e kanë për obligim dhe në dorën e tyre ta luajnë familjet e heronjve Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla.

Tre ranë, më mijëra u ngritën - Kosova fitoi Republikën. Ky është epilogu i 26-vjeçarit (17 janar 1982 - 17 shkurt 2008) i luftës së Lëvizjes Kombëtare Çlirimtare të Kosovës.



Greva në arsim vazhdon



PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) përmes një komunikate për media ka theksuar se askush mos të provojë të bëjë presion kundër grevës në arsim. "Kjo është e ndaluar me Ligjin e grevës dhe se, po ndodhi cilado formë e presionit, SBASHK-u do të ngrehë padë ndaj cilitdo qoftë në gjykatat gjegjëse", është bërë me dije në komunikatën e SBASHK-ut. Në këtë komunikatë është theksuar se edhe në ditën e katërt, bazuar

në raportet e çerdheve, të shkollave fillore dhe të mesme dhe universiteteve, të gjitha institucionet arsimore të Kosovës ishin në grevë të përgjithshme. Sipas kësaj komunikate, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, me bashkëpunëtorë të enjten ka vizituar Komunën e Malishevës dhe atë të Prizrenit.

Në Malishevë delegacioni i SBASHK-ut, i shoqëruar nga kryetar i sindikatës komunale të arsimit fillor dhe arsimit të mësim për këtë komunë, Elez

Krasniqi, kanë vizituar grevistët në çerdhe, në Qendrën e Kompetencave, në Gjimnazin "Hamdi Berisha" dhe në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Ganimete Tërbeshi". "Grevistët në të gjitha këto institucione janë shprehur se do ta vazhdojnë grevën e përgjithshme deri kur institucionet ta realizojnë kërkesën legjitime e të drejtë të SBASHK-ut për përmirësimin e koeficienteve, së paku për 30 përqind", është bërë me dije në këtë komunikatë.

37 vjet nga vrasja e vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës

Vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka dhanë kontribut të shquar në rritjen e ndërgjegjes kombëtare

Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka u vranë mizorisht në Gjermani në vitin 1982 nga regjimi ish-jugosllav. Në 37-vjetorin e vrasjes së tyre, përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe liderë partish kanë theksuar se vrasja e tyre ishte një prej goditjeve më të rënda të lëvizjes çlirimtare, e cila po i bashkërendonte veprimet brenda dhe jashtë Kosovës



goditje e rëndë për lëvizjen e shqiptarëve të Kosovës, por gjithashtu ata u shndërruan në prijës të kauzës për lirinë e Kosovës, duke trasuar rrugën e qartë drejt lirisë, pavarësisë dhe demokracisë në Kosovë. Jusuf Gërvalla ishte një intelektual i jashtëzakonshëm, që me vizionin e tij politik dhe vendosmërinë atdhetare, së bashku me Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën u bënë prijës të lëvizjes kombëtare nën regjimin komunist dhe me përkushtimin e tyre të pasqorë arritën ta ngritnin nivelin e organizimit dhe unifikimit të veprimtarëve shqiptarë në kuadër të lëvizjes kombëtare për lirinë e Kosovës", ka thënë Mustafa.

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 JANAR - 17 janari i vitit 1982 është dita kur u vranë në një atentat vëllezërit Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Edhe pse kanë kaluar 37 vjet, ajo ditë mbetet përgjithnjë e freskët me zinë e saj jo vetëm për familjet, por edhe për një numër njerëzish që kanë qenë të lidhur shpirtërisht e organizativisht me këta tre veprimtarë. Atentati mbi dy vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën ka ndodhur në Untergruppenbach të Gjermanisë. "Der Spiegel" më 25 janar 1982 kishte shkruar për motivin e krim-it, duke theksuar se identifikimi i shpejtë i viktimave e ka sqaruar edhe motivin dhe drejtimin politik të tyre: "Jugosllavë në ekzil që i takonin kombësisë shqiptare nga provinca e Kosovës në jug të

shtetit ballkanik, dhe që të tre veprimtarë kundër qeverisjes së Beogradit". Dymbëdhjetë herë ishte gjuajtur mbi të tre burrat nga pistoletat e kalibrit 7.65, dhjetë goditje kishin qëlluar zemrën, mushkëritë dhe qafën. Një polic në vendin e ngjarjes kishte thënë: "E tëra dukej si një ekzekutim". Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka kujtuar tre veprimtarët e lëvizjes kombëtare: Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën dhe Bardhosh Gërvallën. "Nga dora e shërbimeve sekrete serbe, para 37 vjetësh në Gjermani u vranë tre veprimtarë të shquar të lëvizjes kombëtare: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Vrasja e tyre ishte një prej goditjeve më të rënda të lëvizjes sonë çlirimtare, e cila po i bashkërendonte veprimet brenda

dhe jashtë Kosovës. Si veprimtarë të një ideali dhe përpjekjeve të pareshtura për liri, ata dhanë kontribut të shquar për rritjen e ndërgjegjes kombëtare, për organizimin politik dhe për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës në botën perëndimore", ka thënë presidenti Thaçi. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka përkujtuar vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën në 37-vjetorin e rënies së tyre. "Janari është muaji i rënies tonë. Sot, më 17 janar, është 37-vjetori i rënies së Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, të tre veprimtarë të mëdhenj të lëvizjes sonë kombëtare për lirinë e Kosovës. Nderimi për heronjtë e kombit, për dëshmorët e lirisë, çdoherë na bën më të fortë e më të përkushtuar në rrugën e fuqizimit të shtetit të pavarur e sovran të Kosovës", ka thënë Veseli.

Po ashtu, edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka përkujtuar vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën, në 37-vjetorin e vrasjes së tyre. "Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka u vranë mizorisht në vitin 1982 nga regjimi ish-jugosllav. Vrasja e tyre ishte një vendit, deri në mobilizimin e përgjithshëm të popullit tonë, në fundin e shekullit njëzet. Nderim i përjetshëm heronjve të kombit, që i dhanë drejtim projektit të shumë brezave, deri në lirinë e plotë", ka shkruar kryeministri Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën i ka kujtuar edhe zëvendëskryeministri dhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. "Në 37-vjetorin e rënies përkujtojmë veprimtarët e hershëm të lëvizjes tonë kombëtare, Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën. Vëllezërit Gërvalla e Kadri Zeka me vendosmërinë e tyre politike e atdhetare trasuan rrugën e lirisë dhe shtetësisë së Kosovës. Ndonëse kanë kaluar 37 vjet nga vrasja e tre kolosëve tanë, kujtimi për ta mbetet gjithmonë i freskët", ka thënë Limaj.



Edhe kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka thënë se me vrasjen e tre lajmëtarëve të lirisë u tentua të shuhej zëri i Kosovës dhe e vërteta e saj. "Vepra e vizoni i tyre ishin frymëzim dhe udhërrëfyes i të gjitha gjeneratave vijuese në angazhimet për lirinë e

Për 37-vjetorin e vrasjes së tyre ka folur edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosjes, Albin Kurti, i cili ka thënë se vrasja e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës dhe e Kadri Zekës ndodhi në një çast të rëndësishëm në historinë e rezistencës e të organizimit çlirimtar të shqiptarëve. "UDB-a i eliminou këta tre veprimtarë të shquar në kohën kur Jusufi dhe Kadri me shokë po punonin që të bashkoheshin organizatat ilegale të kohës. Bashkimi i organizatave ndodhi pas vrasjes së tyre. Dhe, ky ishte një hap i rëndësishëm pa të cilin do të ishte pamundur organizimi për luftë çlirimtare në vitet '90 e i cili kulmoi me UÇK-në", ka thënë Kurti, duke shtuar se liria e Kosovës ka qenë ëndrra e përjetshme dhe puna e përditshme e këtyre veprimtarëve. "Sot, kur shohim rininë tonë të zhgënjyer nga liria, nuk mund të mos mendojmë se shumëçka është bërë gabim, sepse nuk janë respektuar ëndrrat e dëshmorëve, por urdhrat e tiranëve", ka deklaruar Kurti.

Hapet zyra për programin 'Evropa Kreative'

EPOKA E RE
Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 JANAR - Në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" të enjten është hapur zyra për programin "Evropa Kreative-Kosovë". Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se hapja e zyrës për programin "Evropa Kreative" është një aktivitet i rëndësishëm kulturor për faktin se Kosova do të përfitojë tashmë nga programi i Bashkimit Evropian "Evropa Kreative", sektorët e saj kulturorë dhe krijues do të forcohen, ndërsa audiencat në Kosovë dhe përtej do të përfitojnë nga shtimi i diversitetit kulturor. "Evropa Kreative do t'u mundësojë mijëra artistëve dhe profesionistëve të kulturës, edhe mijëra

organizatave krijuese dhe botuesve, të punojnë së bashku dhe t'i bëjnë veprat e tyre krijuese të disponueshme për miliona qytetarë, me ç'rast organizatat e Kosovës do të kenë mundësi të aplikojnë për grante për projekte shumëvjeçare bashkëpunimi, për përkthime librash, për krijimin e platformave kulturore shumëkombëshe", ka thënë ministri Gashi. Ai ka shtuar se pjesëmarrja në programin "Evropa Kreative" do të kontribuojë njëkohësisht për forcimin e kapaciteteve në sektorin kulturor dhe krijues duke promovuar kulturorë dhe duke përmirësuar qasjen në veprat kulturore dhe krijuese evropiane si dhe në forcimin e inovacionit dhe krijimtarisë në fushën e kulturës.

Po ashtu, ministri Gashi ka thënë se kjo marrëveshje e arritur me Komisionin Evropian synon integrimin e Kosovës në rrjetet evropiane të komunikimit dhe të kulturës, duke e bërë Kosovën pjesë të hartës kulturore evropiane, përmes asaj që quhet diplomaci dhe integrim kulturor. "Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ratifikimit dhe hyrjes në fuqi, ne si Ministri kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për krijimin e strukturave përkatese, themelimin dhe funksionalizimin e Zyrës për Programin 'Evropa Kreative'. Në kuadër të kësaj, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbetet në vazhdimësi e përkushtuar që të krijojë dhe të zhvillojë politika, ambient dhe mekanizma të përshtatshëm për promovimin e aktiviteteve kulturore", ka



deklaruar ministri Gashi. Ndërkaq ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se ky program do t'u mundësojë artistëve kosovarë t'i promovojnë veprimtaritë e tyre

artistike në gjithë botën. "Ministria që unë drejtoj ka mandat për krijimin e donacioneve në vend dhe përfituesit të donacioneve të jenë të gjithë sektorët në Kosovë", ka thënë Hoxha.

Gazmend Syla emërohet kryesues i Komitetit Ndërministror për Kompleksin "Adem Jashari"

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Këshilltari politik i kryeministrit Ramush Haradinaj, Gazmend Syla, është emëruar kryesues i Komitetit Ndërministror për Kompleksin

Memorial Adem Jashari. Ai është zotuar se do të bëjë më të mirën e mundshme për ta finalizuar siç duhet Kompleksin Memorial në Prekaz. Syla ka thënë se ky kom-

pleks është pjesë e dhimbjes dhe krenarisë shqiptare. "Do të përpiqemi të bëjmë më të mirën e mundshme, që të finalizojmë ashtu siç i ka hije këtë kompleks, që është

pjesë e dhimbjes dhe krenarisë sonë. Lavdi komandantit legjendar Adem Jashari! Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!", ka shkruar Syla në llogarinë e tij në "Facebook".



Banka Botërore, mision identifikues për projekte investive në ujësjellësin e Prishtinës

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 JANAR - Përfaqësues të Bankës Botërore të enjten kanë vizituar Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" sh. a. Në takim kanë marrë pjesë Susanna Smets, specialiste për ujë dhe ujëra të zeza nga Banka Botërore, Bekim Imeri, specialist për zhvillim social, po ashtu nga Banka Botërore, si dhe kryeshefi ekzekutiv Ilir Abdullahu me stafin përcjellës. Qëllimi i këtij takimi me përfaqësues të Bankës Botërore si partnerë shumë të rëndësishëm strategjikë për sektorin e ujit, ishte diskutimi i projektit të Bankës Botërore për identifikimin e investimeve potenciale afatgjatë në KRU "Prishtina".

Përfaqësues të Ujësjellësit të Prishtinës kanë shpalosur projektpropozimet në fushat më të nevojshme për investime siç janë, zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale (ka dorëzuar kërkesën për studim fizibiliteti për menaxhimin e presionit), ruajtja dhe menaxhimi i resurseve ujore si dhe



kursimi i shpenzimeve të energjisë elektrike përmes investimeve në ndërtimin e paneleve solare që do t'i ulte shpenzimet operative si rezultat i kostos së lartë të energjisë elektrike.

Kryeshefi ekzekutiv i KRU "Prishtina", Ilir Abdullahu, ka paraqitur para Bankës Botërore studimin e fizibilitetit me arsyesh-

mëritë e ngritjes së impianteve energjetike fotovoltaike në tri zona të shërbimit (Shkabaj, Albanik, Selia Qendrore) planet konkrete zhvillimore në reduktimin e humbjeve të ujit të pafaturuar, si dhe ka diskutuar rreth furnizimit me ujë të zonave rurale, me theks të veçantë rreth nevojave për ujë të pijshëm dhe ujitje në zonat me

resurse ujore të pakta.

Një studim fizibiliteti ishte hartuar vitin e kaluar nga Komuna e Drenasit për ndërtimin e akumulacionit si dhe nevojat për investime të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza për mbrojtjen e lumit Drenica dhe ujërave nëntokësore në ato zona.

Ndër të tjera, kryeshefi Abdullahu

ka falënderuar Bankën Botërore si partnere strategjike për misionin e tyre për identifikimin dhe përkrahjen e projekteve investive dhe afatgjatë për kompaninë rajonale të ujësjellësit të Prishtinës. Ndërkaq përfaqësuesit e Bankës Botërore u zotuan se projektpropozimet do t'i diskutojnë në komitetet e tyre teknike.

Mjekë nga Suedia po operojnë pacientë në QKUK



**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 JANAR - Një ekip i mjekëve nga Suedia, i përbërë nga kirurgë plastikë dhe anesteziologë, po qëndron në QKUK dhe po trajton pacientë në bazë të një bashkëpunimi në mes të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe Qendrës Klinike Universitare të Linkopingut të Suedisë, i cili ka nisur në vitin 2001.

Bashkë me kirurgët nga Kosova, në Klinikën e Kirurgjisë Plastike këtë javë ata kanë kryer tri operacione mikrokirurgjike në bazë të planifikimeve të bëra. Drejtori i Kirurgjisë Plastike në

QKUK, dr. Zenë Buja, e vlerësoi lart bashkëpunimin me kirurgët suedezë. Përveç ndihmës profesionale, Buja ka theksuar se Suedia i ka furnizuar edhe me pajisje mjekësore.

"Bashkëpunimi me mjekët suedezë daton që nga viti 2001 është një bashkëpunim shumë i mirë, shumë i suksesshëm, për arsye se ky ekip i mjekëve suedezë na ka ndihmuar shumë si në aspektin e ngritjes sonë profesionale, po ashtu na kanë ndihmuar edhe me pajisje mjekësore", ka thënë Buja.

Erkki Torpilla, mjek nga Suedia, foli për intervenimet kirurgjike dhe tregoi për aktivitetin e ekipit

që drejton ai, me të cilën po qëndron në Kosovë që nga dita e hënë. "Qëllimi dhe misioni ynë është që t'i japim përvojat tona, për kolegët tanë kirurgë plastikë. Fillimisht kemi bërë konsultime për vështirësitë rreth rasteve të operimeve plastike. Gjithashtu, kemi bërë shumë vizita dhe kemi dhënë rekomandime për kolegët tanë se si të veprohet ose jo. Kemi kryer operacione ku kemi menduar se ka përfitime në aspektin edukativ", ka deklaruar Torpilla. Mjekët nga Suedia do të qëndrojnë në Kosovë deri ditën e premte. Kjo qendër universitare ka pasur bashkëpunim edhe me klinikat e tjera të QKUK-së.

Nderohet Gjergj Kastrioti Skënderbeu në 551-vjetorin e vdekjes

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, dhe kryeministri Ramush Haradinaj të enjten kanë bërë homazhe te shtatorja e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, me rastin e 551-vjetorit të vdekjes së tij. "Janari është muaji i rënies të mëdha në

historinë e kombit tonë. Sot, më 17 janar, nderojmë kujtimin e kryeheroit tonë kombëtar - Gjergj Kastriotit-Skënderbeun, në përvjetorin e vdekjes së tij. Nderimi për heronjtë e kombit, për dëshmorët e lirisë, çdoherë na bën më të fortë e më të përkushtuar në rrugën e

fuqizimit të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës", ka thënë Veseli.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se sot 550-vjetorin e vdekjes po nderojnë heroin kombëtar Gjergj Kastriotin Skënderbeun. Ky aktivitet shënon edhe përmbylljen

e Vitit Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu të shpallur nga Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë në vitin 2018, në nderim të 550-vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar, në nderim të të cilit janë zhvilluar shumë aktivitete.



Haziri kërkon ndërprerjen e grevës në shkollat e Gjilanit

GJILAN, 17 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga drejtori i Arsimit, Nazim Gagica, ka vizituar grevistët në shkollën fillore "Sadulla Brestovci" dhe edukatorët e

çerdhes "Ardhmëria II". Me këtë rast, Haziri ka kërkuar ndërprerjen e grevës, në të njëjtën kohë ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës përmbushjen e të gjitha kërkesave të Sindikatës së Bashkuar të

Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK). "Kërkesat e grevistëve janë të drejta, por humbja e mësimit është humbje e madhe për nxënësit. Prandaj, kërkoj nga SBASHK-u që ta ndërpresë

grevën dhe nxënësit t'i kthehen procesit të rregullt mësimor. Por, kërkesa ime drejtuar Qeverisë është që t'i përmbushë të gjitha kërkesat e Sindikatës", ka thënë Haziri.



MTI-ja: Bizneset t'i vendosin flamujt që tregojnë origjinën e mallit

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Zëvendësministria e Tregtisë dhe Industrisë, Arbëreshë Krasniqi, bashkë me kryeinspektorin e MTI-së, Lulzim Sylja, kanë vizituar të enjten disa markete për të parë nga afër zbatimin e udhëzimit administrativ për vendosjen e flamujve që tregojnë origjinën e mallit.

Zëvendësministria Krasniqi ka theksuar se qëllimi i këtyre vizitave është sensibilizimi i bizneseve që ta zbatojnë udhëzimin administrativ dhe të fillojnë vendosjen e flamujve. Ajo u shpreh se qytetarët e kanë pritur mirë vendosjen e flamujve që tregojnë origjinën e mallit. "Ne sot vizituam disa markete në Prishtinë. Arsyja e vizitës është vendosja e flamujve, që është përcaktuar me udhëzim administrativ të MTI-së, i cili ka hyrë në fuqi më 29 dhjetor të vitit 2018, që i obligon të gjithë operatorët ekonomikë ta zbatojnë. Inspektuam sot dhe pamë se vetë qytetarët, kryesisht bizneset, janë të interesuar ta zbatojnë këtë udhëzim. Ne e dimë se moszbatimi i udhëzimit administrativ është shkelje ligjore ku parashihen edhe dënimet", ka



thënë Krasniqi.

Zëvendësministria ka treguar edhe përfitimet që ka ky udhëzim administrativ për qytetarët. Ajo ka theksuar se konsumatorët do të kenë lehtësim gjatë blerjes së produkteve që u nevojiten në përditshmëri. Më tej, Krasniqi ka shtuar se interesimi i MTI-së për të monitoruar dhe inspektuar ecurinë e tij është i madh. "Inspektori po e bën punën e vet dhe do të vazhdojë edhe më tutje, e që konsideroj se kjo çështje do të ndikojë pozitivisht në rregullimin e tregut

në Republikën e Kosovës, njëkohësisht do ta bëjë më shpejt të kuptueshme dhe më të saktë se çka po blejnë konsumatorët. Ky është edhe qëllimi i vendosjes së flamujve. Kjo vlen për të gjitha bizneset. Nuk ka ndasi", ka thënë zëvendësministria Krasniqi. Udhëzimi administrativ ka hyrë në fuqi më 29 dhjetor të vitit 2018 dhe i obligon të gjithë shitësit që në anën e majtë të çmimit ta vendosin edhe flamurin e atij shteti se nga importohet produkti për ta treguar origjinën e mallit.

Partneriteti ekonomik Kosovë - Gjermani, storie e suksesit

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Të enjten është mbajtur takimi 'Business talks', i organizuar nga Oda Ekonomike Gjermane, në bashkëpunim me Konrad Adenauer Stiftung, ku të pranishëm ishin kryeministri Ramush Haradinaj, ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, investitorë gjermanë dhe sipërmarrës nga vendi. Kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar në këtë takim se partneriteti ekonomik Kosovë - Gjermani është storie e suksesit. Ai ka thënë se sot Kosova ka një infrastrukturë që është mbi 40 milionë euro që është bërë nga

Qeveria gjermane. "Ne kemi marrë vendim që të investohen 11 milionë euro deri në vitin 2021. Një tjetër lajm i mirë është se një kompani gjermane që është në konsorcium edhe me palë të tjera është e parakualifikuar në bazë të vlerësimit të Ministrisë së Tregtisë dhe procesi është i gatshëm që të lajmërohet investitori i parë me investime strategjike në energji me erë", ka thënë Haradinaj.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeministri Haradinaj ka thënë se tanimë beson se rritja ekonomike do të shkojë rreth 4.3 për qind në Kosovë.



Komuna e Prizrenit organizon debat publik për projektin e autostradës

PRIZREN, 17 JANAR (ER) - Projekti i Ministrisë së Infrastrukturës për ndërtimin e autostradës me gjatësi prej 91 kilometrash të segmentit Istog - Pejë - Deçan - Gjakovë - Prizren është në fazën e shqyrtimit të varianteve të projektit ideor. Për të siguruar një vendimarrje të drejtë, transparente, kualitative dhe për të definuar një variant më të përshtatshëm të trasesë së Autostradës, Komuna e Prizrenit në



bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe kompaninë kontraktuese do të organizojë debat publik lidhur me përcaktimin e variantit më të favorshëm

të projektit ideor për segmentin e autostradës që kalon nëpër territorin e Prizrenit. "Ftohen të gjitha subjektet afariste, ndërmarrjet publike, profesionistët e fushave të ndryshme, qytetarët, palët e tjera të interesit dhe anëtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit, që të jenë pjesë e këtij debati. Debati publik do të organizohet më 29 janar, në orën 13:00, në Sallën e Kuvendit Komunal në Prizren", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

Komuna e Prishtinës: Po rimëkëmbët Pallati i Rinisë

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se Pallati i Rinisë, i cili është kthyer në pronësi të kësaj komune, ka mbledhur të hyra rekorde. Po ashtu, kjo komunë ka bërë me dije se janë paguar të gjitha pagat për punëtorët e këtij pallati si dhe një pjesë e vogël e borxhit. "Pallati i Rinisë për një muaj e gjysmë ka mbledhur të hyra rekorde. Janë paguar të gjithë pagat dhe një pjesë e vogël e

borxhit. Së shpejti do të paguhet i tërë borxhi, pastaj fillojmë projektet kapitale për renovimin e pjesëve të ndryshme të objektit. Pallati i Rinisë po rimëkëmbet", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Malisheva njoftohet me programet e granteve nga zyra japoneze në Prishtinë

MALISHEVË, 17 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar nga nënkryetari Hajdin Berisha, drejtori për Arsim, Blerim Thaçi, ai për Emergjencë, Valon Gashi, dhe drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Liridon

Hoti, kanë pritur në një takim koordinatorin e projekteve pranë zyrës japoneze në Prishtinë, Mark Rodiqi, me të cilin kanë diskutuar rreth granteve dhe projekteve të kësaj zyre. Koordinatori Rodiqi i ka informuar zyrtarët e Komunës së

Malishevës me programet e zyrës japoneze për ndihma pa kthim për institucionet komunale, në fusha të caktuara, përkatësisht me grantet që ofrohen nga zyra japoneze në Prishtinë dhe afatet për aplikim. Fushat në të cilat ofrohen këto grante, janë në

emergjencë, shëndetësi, arsim dhe shërbime publike.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e ka falënderuar zyrtarin pranë zyrës japoneze në Prishtinë për ofrimin e informacioneve. Po ashtu, ai e ka falënderuar qeverinë japoneze për përkrahjen e



vazhdueshme që ka dhënë për Kosovën në përgjithësi, e në veçanti për Malishevën.

KSTRr-ja nxjerr dy vendime për rritjen e sigurisë në trafikun rrugor

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Këshilli i Sigurisë së Trafikut Rrugor (KSTRr) të enjten ka votuar dy vendime që rrjedhin nga rekomandimet e Task Forcës për Siguri në Trafikun Rrugor. Këto vendime u

propozuan nga ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, që është edhe kryesues i KSTRr-së. I pari kërkon evidentim në bazën qendrore të të dhënave të Policisë së Kosovës për të gjitha

mjetet rrugore të përfshira në aksidente trafiku, të cilat do të publikohen më pas edhe online, ndërsa vendimi i dytë përfshin inspektim të infrastrukturës rrugore sipas standardeve evropiane të sigurisë.

Këshilli u njoftua edhe me të tjera rekomandime që janë rezultat i punës gjashtëmujore të Task Forcës dhe ka dhënë edhe propozimet përkitazi me dikasterin që përfaqëson me qëllim të përmirësimit të



gjendjes së sigurisë në komunikacion në mbarë vendin.

Nënshkruhet marrëveshja grant për rrugën Kijevë - Zahaq

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 JANAR - Qeveria e Kosovës, e përfaqësuar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, dhe Banka Evropiane për Investime, e përfaqësuar nga Matteo Rivellini, udhëheqës i Divizionit për Slloveni, Kroaci dhe Ballkanin Perëndimor në Bankën Evropiane për Investime (BEI), kanë nënshkruar të enjten marrëveshjen grant për implementimin e projektit të autostradës Prishtinë - Pejë, segmenti Kijevë - Zahaq. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit ministri Hamza ka theksuar se është gjithmonë kënaqësi kur nënshkruhen marrëveshje për mbështetjen e projekteve të rëndësishme si ky i cili lidh qytetin e Pejës me kryeqytetin.

Më tutje, ai ka thënë se Banka Evropiane për Investime vazhdon të jetë një ndër partnerët kyç strategjik të Kosovës për realiz-

imin e projekteve të mëdha infrastrukturore, duke shprehur vullnetin e Ministrisë së Financave për të shtuar dhe zgjeruar bashkëpunimin aktual edhe në sektorë të tjerë. "Kjo marrëveshje grant kompletin financimin e ndërtimit të autostradës Prishtinë - Pejë, segmentit Kijevë - Zahaq, për të cilin projekt tanimë janë nënshkruar dy marrëveshje kredie me BEI dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ndërsa Korniza Investive e Ballkanit Perëndimor ka ndihmuar në përgatitjen e studimeve të nevojshme për realizimin e këtij projekti me vlerë prej 3.2 milionë eurove", ka thënë Hamza. Ai ka bërë me dije se Ministria e Financave është duke punuar në vazhdimësi së bashku me donatorë dhe institucione financiare ndërkombëtare për të gjetur financim për realizimin e projekteve të rëndësishme për qytetarët e Kosovës.

Udhëheqësi i Divizionit për



Slloveninë, Kroacinë dhe Ballkanin Perëndimor në Bankën Evropiane për Investime, Matteo Rivellini, ka thënë shprehur edhe një herë gatishmërinë e Bankës për ta mbështetur zhvillimin ekonomik të Kosovës përmes realizimit të projekteve prioritare për vendin. "Jam i nderuar që sot po nënshkruajmë marrëveshjen e parë të grantit nën "Economic Resilience Initiative" në Kosovë.

Ky grant në vlerë prej një milion eurosh do ta komplimentojë grantin e BE-së nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor (WBIF) dhe do të ofrojë asistencë teknike për të siguruar se autostrada në mes të Kijevës dhe Zahaqit do të ndërtohet sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Banka Evropiane për Investime vazhdon të mbështesë projekte të rëndësishme që kanë

impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik, siç është ky i cili synon të lidhë njerëzit dhe bizneset në Kosovë dhe më gjerë. Mirëpresim zbatimin e suksesshëm të këtij projekti", ka thënë ai.

Ndërsa ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka theksuar se kjo marrëveshje po na ofron edhe më shumë drejt konkretizimit dhe fillimit të punimeve për të përmbyllur një projekt shumë qenësor për pjesën e Dukagjinit. "Ne edhe sot i jemi mirënjohës Bankës Investive Evropiane që si në çdo rast tjetër po e mbështet zhvillimin e projekteve infrastrukturore. Po ashtu, nuk mund pa e përmend edhe angazhimin e pandalshëm e të palodhshëm të ministrit Hamza dhe të stafit të tij që po e bëjnë të mundur në mënyrë profesionale dhe të shpejtë arritjen e këtyre marrëveshjeve me institucionet financiare ndërkombëtare për financimin e projekteve të rëndësishme për qytetarët e Kosovës", ka thënë Lekaj.

Bizneset të informohen më shumë mbi pronësinë intelektuale

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar punëtori mbi pronësinë intelektuale në Kosovë dhe Bashkim Evropian, ku bizneset e pranishme u njoftuan mbi zhvillimet më të reja në këtë fushë si dhe progresin e arritur për zbatimin e obligimeve nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit. Kjo punëtori u organizua në kuadër të një projekti që financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Kujtesa Nezaj-Shehu, konsulente, mbajti një prezantim mbi të



drejtën e pronësisë intelektuale, ku u sqaruan llojet e pronësisë intelektuale, mekanizmat ekzistues në këtë fushë si dhe obligimet e Kosovës që dalin nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit. Ajo sqaroi se legjislacioni në masë të madhe është i

harmonizuar me direktivat e BE-së, mirëpo duhet të bëhen përmirësime ende në zbatim të këtij legjislacioni.

Drejtori i Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe Drejtat e Përafërta, Valon Kashtanjeva, ka sqaruar rolin e zyrës që ai drejton, duke

shtuar se bizneset ende nuk janë informuara sa duhet mbi rëndësinë e kësaj fushe. Ai ka treguar në detaje llojet e veprave që hyjnë në kuadër të të drejtës së autorit. Kashtanjeva ka shtuar se për dalim nga pronësia industriale, veprat që hyjnë në këtë kategori

nuk kanë nevojë për regjistrim pasi që mbrojtja ofrohet që nga krijimi i veprës.

Drejtori i Agjencisë për Pronësi Industriale, Nezir Gashi, ka përmendur sfidat që agjencia ka pasur në këtë drejtim, duke potencuar nevojën e ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe financiare të agjencisë. Ai, po ashtu, ka njoftuar të pranishmit se vetëdijësimi i bizneseve mbi pronësinë intelektuale si dhe zbatimi i saj duhet të jetë ndër prioritetet e institucioneve në mënyrë që të arrihet implementimi dhe zbatimi i obligimeve të dala nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit.

ATK-ja shënon 19-vjetorin e themelimit

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - "Sot në përvjetorin e 19 të ATK-së falënderova tatimpaguesit e vendit, ata që për gjithë këto vite kanë mbushur arkën e shtetit. Duhet ta keni parasysh dobinë e madhe që keni, në sigurimin e buxhetit, kryerjen e detyrave tuaja dhe orientimin tonë

euroatlantik", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në shënimin e 19-vjetorit të themelimit të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, pasi ka përgëzuar Administratën Tatimore për arritjet, ka thënë se falë kësaj

pune sot Kosova është shembull sa i përket stabilitetit makrofiskal dhe kjo është e mundur si rezultat i punës dhe angazhimit shumë të madh të punonjësve të ATK-së. Ndërkaq, drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Sakip

Imeri, ka thënë se Administrata Tatimore e Kosovës është konsoliduar në nivel të një institucioni kompetent, me integritet të lartë profesional dhe modern, në linjë me zhvillimet e përgjithshme ekonomike, teknologjike dhe administrative dhe e krahasuar me admin-



istratat tatimore moderne ndërkombëtare.

E rrallë

Macet jetojnë në apartamentin me qira, kushton 1 500 euro në muaj



Një çift jeton në një apartament në San Francisko me qira 1 500 euro në muaj. Pronari i shtëpisë i quajti "qiramarrësit shumë të qetë". Tina dhe Louise, ky është emri i maceve qimegjatë që jetojnë si një pasha në një banesë luksoze. "The

Independent" ka raportuar se pronari i dy maceve është Troy Good. Ai nuk ka mundur t'i mbajë më kafshët në banesën e vet, pasi qeni i tij i vogël nuk pajtohej me macet. Kështu që u detyrua të marrë me qira një apartament të shtrenjtë 1 500 euro.

FOTO E DITES



Një pjesë e urës së vjetër të Tappan Zee në Nju Jork është rrëzuar me eksploziv. /AP/

E jashtëzakonshme

Bullgaria bën transplantimin e parë në botë të brinjëve

Transplantimi i parë në botë i brinjëve u krye në spitalin Tokuda në Sofje të Bullgarisë, duke përdorur një zëvendësues të përbërë me një printer 3D, të futur te 35-vjeçari Ivaylo Josifov. Ky person ishte diagnostikuar me rritjen e brinjës së pestë, të shkaktuar nga një defekt i



lindur. Kjo mund të përkeqësohet me kalimin e kohës dhe mund të shkaktojë probleme në gjoks dhe në frymëmarrje, prandaj mjekët vendosën se duhej të hiqej.

BARSOLETA E DITËS



Burri:
- Zemër, çfarë u bë kaq e pastër shtëpia?
Gruaja:
- Se s'ka pasur internet gjithë ditën.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Nëse keni parë që persona të caktuar nuk kanë shumë simpati për ju, sot duhet të bëni të mundur që ky opinion të ndryshojë.</p>	 <p>DEMI Gjeni guximin dhe hiqni dorë nga një situatë që nuk po e mbështetni më. Megjithëse do të thotë shumë për ju, duhet ta merrni si vendim.</p>	 <p>BINJAKËT Nuk keni pse të mërzhiteni nëse gjërat kanë marrë një rrjedhë të caktuar. Keni qenë ju vetë që jeni bërë shkak për këtë rezultat.</p>	 <p>GAFORRJA Sot do ta keni të vështirë të merrni një vendim. E dini që shumë nga personat që keni pranë do të preken nga kjo gjë.</p>	 <p>LUANI Nëse e dini që një koleg juaji merret shumë me llafe, nuk keni pse i konfidoni një projekt tuajin. Do ta marrë të gjithë meritën.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Në fushën profesionale s'po ndiheni shumë mirë sot. Për këtë arsye keni dyshime të forta të mbyllni marrëveshje dhe kontrata me persona të tjerë.</p>
 <p>PESHORJA Duhet të eliminoni çdo formë stresi në ditët në vijim. Nëse ende nuk keni vendosur për të ndërmarrë një veprim, sot është dita.</p>	 <p>AKREPI Sot do të jetë një ditë relaksimi që keni dëshirë ta kaloni sa më larg ambientit të punës. Një piknik ose një shëtitje në plazh janë ato që po kërkoni.</p>	 <p>SHIGJETARI Nëse sot nuk doni të jeni shumë i zënë me punë, bëni mirë të mos lini takime ose orare të reja. Mund të keni përplasje takimesh.</p>	 <p>BRICJAPI Sot do t'ju plotësohet çdo kërkesë. Duhet të jeni mirënjohës ndaj një eprori ose të afërmi tuaj që ju kanë kaq për zemër.</p>	 <p>UJORI Sot duhet të arrini një qëllim të caktuar edhe nëse do t'ju duhet të bashkëpunoni me armiq të tuaj. Po pasi thuhet se çdo qëllim justifikon mjetin.</p>	 <p>PESHQIT Është shumë e thjeshtë t'i shtyni gjithmonë gjërat për nesër. Sot, nëse nuk doni të impenjoheni me një person, duhet t'ia thoni.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

GETAFE - ALAVES

1

LILLE - AMIENS

1

CHATEAUROUX - VALENCIENNES

1

Beqiri tregon pengun si futbollist dhe ëndrrën si gjyqtar

Ish-futbollisti i Drenicës nga Skenderaj, Besar Beqiri, për "Epokën e re" ka thënë se punën që e kryen si gjyqtar i futsallit e bën me shumë krenari dhe se do të mundohet ta prezantojë Kosovën në mënyrën më të mirë në arenën ndërkombëtare. "Synimet për të ardhmen janë ta kryej punën me përkushtimin më të madh dhe ta prezantoj futbollin e Kosovës dhe Federatën e Futbollit në mënyrë sa më të mirë në arenën ndërkombëtare", ka thënë Beqiri

**EPOKA ERE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 17 JANAR - Besar Beqiri është një nga sportistët me një histori mjaft të veçantë, pasi karrierën e nisi si futbollist dhe pritet ta përfundojë si gjyqtar. Beqiri të enjten për "Epokën e re" ka folur për jetën e vet, duke treguar edhe ëndrrën që nuk arriti të realizonte asnjëherë. "Kam filluar të merrem me futboll shumë herët. Në moshën 16-vjeçare kam startuar si junior në KF Drenica. Një vit më vonë kam kaluar në ekipin e parë si portier i dytë. Në Drenicë kam qëndruar pesë vjet, pastaj jam larguar për një sezon të Hajvalia, sërish jam kthyer në Drenicë, por si portier i parë. Në

moshën 25-vjeçare e kam përfunduar karrierën dhe pengun më i madh është mosarritja e fitimit të një trofeu me skuadrën e Drenicës", ka thënë Beqiri. Ish-portieri i skuadrës së Drenicës tash është gjyqtar i futsallit, detyrë të cilën e kryen me mjaft përkushtim dhe pasion të madh. Për daljen në garat ndërkombëtare, Beqiri e bën meritë legjendën e futbollit të Kosovës dhe ish-kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, i cili ka ndërruar jetë në qershor të vitit të kaluar. "Të them drejtën si futbollist ashtu edhe gjyqtar ke vështirësi, por ndihem më mirë në punën që e bëj tash. Gjyqtarët vendosin dhe kjo të bën përgjegjës për

veprimet që i merr, kurse personalisht përpiqem gjithmonë që të marr vendimin më të drejtë. Jam i lumtur që kam arritur të bëhem gjyqtar me stemë të FIFA-s për çka kam punuar jashtëzakonisht shumë, por kjo është meritë e ish-kryetarit të Federatës, Fadil Vokrri, i cili punoi shumë që edhe ne të jemi të barabartë me gjyqtarët e shteteve të tjera", ka shtuar ai. I pyetur se cila është ëndrra më e madhe për të ardhmen, Beqiri është përgjigjur: "Synimet për të ardhmen janë ta kryej punën me përkushtimin më të madh dhe ta prezantoj futbollin e Kosovës dhe Federatën e Futbollit në mënyrë sa më të mirë në arenën ndërkombëtare".

SHKURT**"SkySports": Zenelin e dëshiron Chelsea**

Reprezentuesi i Kosovës, Arbër Zeneli mund të transferohet në premier Ligë. "SkySports" raporton se skuadra e Chelsea është e interesuar për futbollistin e Heerenveenit, i cili kërkohet edhe nga Galatasaray dhe Ajaxi. Zeneli është ndër lojtarët më meritë për suksesin historik që e arriti Kosova në Ligën e Kombeve.

Ujkani: Gattuso mund ta bëjë burrë Zhegrovën

Edon Zhegrova është në orbitën e Milanit. Ky është lajmi që ka qarkulluar këto ditë në mediet italiane. Futbollisti i Genkut dhe kombëtares së Kosovës nuk po arrin të luajë rregullisht te klubi i tij, mirëpo cilësitë e tij shikohen si një investim i mirë për të ardhmen. Rreth kësaj situatë ka folur edhe Samir Ujkani për "Tuttomercatoweb". "Pa asnjë dyshim që e mbështes. Është i ri dhe ka cilësi të jashtëzakonshme, që i kam parë vetëm te Dybala. Shpresoj se Milani të merret vesh me të. Me Gattuson mund të bëhet burrë, është trajneri që i duhet. Ai është me të vërtetë Messi i ri, siç ka edhe nofken", ka thënë Ujkani.

Shabani largohet nga Flamurtari

Ish-futbollisti i disa skuadrave në Kosovë e Shqipëri, Veton Shabani, është larguar edhe zyrtarisht nga Flamurtari. "Nuk jam më lojtar i KF Flamurtarit. Falënderoj kryetarin Imer Ademi për korrektësinë e treguar për këtë periudhë sa kemi bashkëpunuar dhe i uroj suksese për përmbushjen e objektivave të tyre", ka thënë Shabani.

10 bursistë për Shpresa Olimpikë 2019

Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës në mbledhjen e 28 ka bërë përzgjedhjen e 10 sportistëve të rinj të cilët do të përfitojnë bursa si Shpresa Olimpikë 2019 nga Ministria për Kulturë, Rinë e Sport, bazuar në Rregulloren nr. 03/2013. Përzgjedhja e tyre është bërë pas propozimeve të dërguara nga federatat dhe bazuar në rezultatet e arritura në garat vendore dhe ndërkombëtare. Listës prej 10 sportistëve iu prijnë dy xhudistët: Erza Muminoviç, medaliste e bronzit në Lojërat Olimpikë për të Rinj, Buenos Aires 2018, njëherësh kampione e Evropës për kadete (U-18), si dhe Shpat Zeka, nënkampion i Evropës për junior (U-20). Dy sportistë u përfshinë edhe nga atletika: Muhamet Ramadani dhe Albina Deliu. Sportistët e parë do të marrin bursa nga MKRS-ja në vlerë 150 euro në muaj gjatë tërë vitit 2019. Lista e sportistëve: Erza Muminoviç (xhudo), Shpat Zeka (xhudo), Muhamet Ramadani (atletikë), Betim Maliqi (karate), Patriot Behrami (boks), Dren Ukimeraj (not), Arlind Selimi (mundje), Arbi Pupovci (skitari), Albina Deliu (atletikë), Fatih Karabaxhaku (pingpong).

FBK-ja dyfishon shpërblimet në ligën e femrave

PRISHTINË, 17 JANAR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) do të vazhdojë t'i shpërblejë klubet e Superligës së Kosovës dhe Ligës së Femrave për rezultatet e arritura në edicionin 2018/19. Në këtë mënyrë skuadra kampione e elitës së basketbollit të Kosovës

do të shpërblehet me 12 000.00 euro, ndërsa ekipit nënkampion do t'i jepen 6 000.00 euro. Ndërkaq skuadrat që do të arrijnë të sigurojnë nga një vend në katërshen e madhe të elitës së basketbollit të Kosovës do të shpërblehen me nga 3 000.00

euro. Skuadra kampione në Ligën e Femrave do të shpërblehet me shumën 4 000.00 euro, do të thotë me dy mijë euro më shumë se në dy vjetët e mëparshëm, marrë parasysh investimet që i kanë bërë disa klube të kësaj lige në këtë edicion, duke e rritur kështu

cilësinë në basketbollin femëror në vendin tonë. Në këtë mënyrë, krahas të hollave nga të drejtat televizive që u ndahen klubeve të Superligës së Kosovës, Bordi i FBK-së vazhdon t'i mbështesë skuadrat e elitës së meshkujve dhe femrave për t'i



inkurajuar, por edhe për t'i ndihmuar sadopak për mbulimin e shpenzimeve.

Shaqiri, ndër lojtarët më të trofeshëm në Angli

LIVERPOOL, 17 JANAR - Xherdan Shaqiri është një nga futbollistit më të mirë shqiptar për momentin. Ai po shkëlqen te Liverpooli, derisa më parë ishte pjesë e Stoke City, Interit, Bayern Munichit dhe Baselit. "talkSPORT" e ka përpiluar një listë ku ka renditur dhjetë futbollistët të cilët kanë fituar më së shumti tituj që luajnë në kampionatin anglez. Në këtë renditje futbollisti shqiptar është renditur në vendin e dhjetë. Shaqiri në karrierën e vet ka arritur të sigurojë gjithsej 13 tituj, gjë që e bën futbollist shumë të suksesshëm. Ylli shqiptar ka arritur ta fitojë tre

herë Superligën zvicerane, dy herë Kupën e Zvicrës, dy herë Bundesligën, dy herë DFB-Lokal si dhe një herë Superkupën gjermane. Shaqiri ka fituar Ligën e Kampionëve, Superkupën e Evropës dhe Botërorin e klubeve me Bayern Munchen.

herë Superligën zvicerane, dy herë Kupën e Zvicrës, dy herë Bundesligën, dy herë DFB-Lokal si dhe një herë Superkupën gjermane. Shaqiri ka fituar Ligën e Kampionëve, Superkupën e Evropës dhe Botërorin e klubeve me Bayern Munchen.



Cikalleshi rikthehet tek Akhisarspori, i etur për suksese

AKHISAR, 17 JANAR - Sokol Cikalleshi ka ndryshuar ekip. Një ditë më parë ishte klubi i Goztepes që njoftoi ndërprerjen e kontratës së huazimit me sulmuesin, i cili u mendua se do të rikthehej tek Osmanlispori. Nuk ka ndodhur kështu. Sulmuesi kavajas ka njoftuar kalimin tek Akhisarspor. Një rikthim për Cikalleshin në këtë ekip. Futbollisti i kombëtares tregon se kishte tri oferta dhe zgjodhi ish-ekipin e tij. Sa i takon rregullores së FIFA-s, pretendohet se rregulli vlen për ekipet e së njëjtës kategori. Cikalleshi në Superligën turke ka luajtur sivjet me Geztepen, kurse me Osmanlisporin në ligën e parë. Kështu, sipas federatës turke, sulmuesit i lejohej të transferohet tek Akhisarspor. "Unë tashmë nuk jam më pjesë e klubit Goztepe. Unë dhe menaxheri im vendosëm t'i shkëpusim marrëdhëniet profesionale me mirëkuptim me klubin për dy arsye: E para: Pasi hapësirat e mia për të luajtur ishin të pakta dhe për shumë arsye kjo vazhdoi shumë



gjatë. E dyta: U hap drita jeshile për të lëvizur te cilido klub në Superligë në merkaton e janarit! Faleminderit Goztepe për bashkëpunimin, edhe pse të shkurtër që kaluam bashkë! Që nga sot me shumë lumturi bëj me dije që mes 3 ofertave që kisha, zgjodha ekipin ku ndihem si në shtëpi, që më hapi dyert pa hezitim për të më bërë pjesë të tyrin, Akhisarspor", ka thënë Cikalleshi.

"Presidenti i ekipit bleu përfundimisht kartonin tim nga klubi Osmanlispor dhe bashkë firmosëm një kontratë 3.5 vjet. Falënderoj klubin Osmanlispor për gjetjen e gjuhës së përbashkët dhe i uroj suksese të mtejshme. Jam shumë i uritur për të luajtur dhe po pres me padurim të zbrës në fushë për ekipin tim të ri", ka shtuar Cikalleshi.

Curry e Duranti dhurojnë spektakël për Golden State, Bostoni i jep 'leksion' Torontos

OAKLAND, 17 JANAR - Golden State konsolidon edhe më shumë pozitën në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores 147-140 ndaj New Orleansit, një sfidë mjaft e bukur dhe madhështore. Madje mysafirët nga Orleansi ishin shumicën e kohës në avantazh, por në periodën e fundit erdhi përmbysja e skuadrës së Warriorsit. Curry me 41 pikë e Duranti me 30 pikë e 15 rebounde ishin dy shënuesit më të mirë për Golden State, ndërsa për miqtë u dallua Davis me 30 pikë e 18 rebounde, por që mbetën për statistikë. Koha shtesë ka qenë fatale për Houstonin, që u mund 145-42 nga Brooklyni, ndeshje që dhuroi shumë emocione deri në minutat e fundit. Një tjetër mbrëmje magjike e Hardenit, me 58 pikë e 10 rebounde, por që këtë herë mbetën për statistikë, pasi nuk e evituan dot humbjen. Për Brooklynin shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë, me Dinwiddie që realizoi 32 pikë e 10 asistime, ndërkohë që 63 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Humbet Clippersi, që u mund 129-109 në fushën e vet nga Utah Jazzi (Mitchell 28 pikë), raporton "Telesport". Fiton



ekipi i Bostonit, që mundi 117-108 Toronton, një përballje mes dy ekipesh pretendente për titull në Lindje. Edhe pse kanadezët dominuan në ndeshje në shumicën e kohës (Leonardo 33 pikë), në 5 minutat erdhi përmbysja e skuadrës së Celticsit, ku u dallua Irvingu me 27 pikë e 18 rebounde. Skuadra e San Antonios mposhti 105-101 Dallasin në derbin teksan, një sfidë e dueluar deri në fund me kolektivitet, që ishte arma kryesore e skuadrës së Spursit (6 lojtarë shënuan mbi 12 pikë).

REZULTATET

Detroit - Orlando	120-115
Boston - Toronto	117-108
Houston - Brooklyn	142-145
Memphis - Milwaukee	101-111
Dallas - San Antonio	101-105
Portland - Cleveland	129-112
Golden State - New Orleans	147-140
Clippers - Utah Jazz	109-129

SHKURT

Dembele transferohet në Kinë

Mesfushori Mousa Dembele nga Tottenham Hotspur është transferuar në ekipin kinez Guangzhou R&F Futbollisti belg është prezantuar te klubi kinez që ka shpenzuar 11 milionë funte për shërbimet e tij. Dembele u transferua në Tottenham nga Fulhami në gushtin e vitit 2012. Që prej asaj kohe ai realizoi 250 paraqitje, duke realizuar 10 gola.

Gattuso: Pse nuk e përdorim VAR-in?

Trajneri i Milanit, Gennaro Gattuso, nuk është dakord me vendimet e gjyqtarit në ndeshjen e Superkupës së Italisë, të cilën kuqezinjët e humbën me rezultatin 1-0 ndaj Juventusit. "Ndëshkimi me karton të kuq i Kessies është i drejtë, por nëse kemi teknologjinë, duhet ta përdorim. Juves i lanë t'i përfundonte dy aksione, me Cutronen ngritën lart flamurin menjëherë", ka thënë Gattuso.

Tottenhami e kërkon Malcomin

Skuadra e Tottenham Hotspurit është alarmuar pas lëndimit të Harry Kanes, i cili do të mbetet jashtë fushave deri në fillim të muajit mars. Një mungesë tjetër për Tottenhamin është edhe Son Heungmin, i cili i është bashkuar ekipit kombëtar të vet në Kupën e Azisë. Në këtë situatë aspak të përshtatshme, Tottenhami e sheh të domosdoshëm transferimin e një emri për fazën e sulmit këtë muaj. "Sport" raporton se Tottenhami ka nisur bisedimet me Barcelonën për transferimin e Malcomit.

Kovaqi: Jamesi luan për të ardhmen e vet

Franck Ribery dhe Arjen Robben janë të lënduar dhe sot (e premte) në ndeshjen ndaj Hoffenheimit pritet të luajë nga fillimi James Rodriguezi. Trajneri Niko Kovaq ka folur rreth aktivizimit të futbollistit nga Kolumbia duke thënë: "Ai luan për të ardhmen e vet. Çdokush që kërkon të ketë një kontratë afatgjatë me klubin duhet t'i tregojë aftësitë e veta".

Scholesi: Mourinho e shkarkoi vetveten

Ish-mesfushori legjendar i Manchester Unitedit, Paul Scholes, ka insistuar se trajneri Jose Mourinho e shkarkoi qëllimisht veten nga klubi, pasi nuk dëshironte t'i drejtonte më "Djajtë e Kuq". "Mendoj se ai [Mourinho] nuk dëshironte të ishte më këtu. Ai e orkestroj largimin e vet në mënyrë të përsosur. Deklaratat e tij në konferencat për shtyp ishin të turpshme, tejet negative. Ishte e qartë në fund se as lojtarët nuk donin të luajnë më për të", ka thënë Scholes. "Gjëja e duhur ndodhi në fund. Ai i prishi marrëdhëniet edhe me Antonio Valencian, i cili është njeriu më i mirë në botë. Është e pamundur të zihesh me të. Kjo ishte shenja e madhe për mua që diçka nuk ishte në rregull. Unë gjithmonë e kam thënë vetëm mendimin tim të sinqertë kur më parashtroheshin pyetje për të. Unë komentoja në bazë të asaj që shihja nga trajneri. Ai filloi të ankohet qysh para se të fillonte sezoni, duke thënë se fëmijët nuk mjaftonin. Kjo nuk më pëlqeu asnjëherë", ka deklaruar Scholes.



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, lidhur me nenin 17 (Ligji nr.03/L-087, dt.13.06.2008, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dt.20.04.2012; me tej ne tekst: Ligji nr. 03/L-087) dhe vendimit të datës 14.01.2019, Bordi i Drejtorëve të TK Sh.A, shpall:

KONKURS PËR VEND TË PUNËS

Titulli i punës: **Kryeshef Ekzekutiv**
Vendi: Prishtinë
Ndërmarrja: Telekom i Kosovës Sh.A
Afati i fundit për aplikim: 16.02.2019, ora 16.00

PËRSHKRIMI I NDËRMARRJES

Telekomi i Kosovës Sh. A (TK) është ndërmarrje publike e licencuar për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të telekomunikacionit në një treg të hapur duke sjellë inovacione dhe risi në tregun e telekomunikacionit. TK është në kërkim të Kryeshefit Ekzekutiv me kualifikim, integritet të njohur dhe përvojë të nevojshme profesionale që do të udhëheqë ndërmarrjen në përputhje me parimet e njohura për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike dhe të vazhdojë zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve të korporatës.

Titulli i punës: Kryeshef Ekzekutiv

Kryeshefi Ekzekutiv (KE), duke i raportuar Bordit të Drejtorëve, drejton të gjitha aktivitetet e TK Sh. A duke koordinuar dhe mbikëqyrë drejtpërdrejt punën e drejtorëve të departamenteve si dhe duke i përmbytur detyrat e veta të përditshme në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, matricën e autoritetit, rregulloret dhe vendimet e Bordit.

Kryeshefi Ekzekutiv duhet t'i plotësojë kushtet e kualifikimit dhe të pavarësisë sipas nenit 21, lidhur me nenin 17, të ligjit 03/L-087, i ndryshuar e plotësuar më vonë.

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e KE janë:

- Zhvillimin strategjik të TK Sh. A. dhe qeverisjen korporative të ndërmarrjes përmes ndryshimeve cilësore dhe me rëndësi esenciale për suksesin e biznesit të saj;
- Zhvillimin dhe implementimin e përpiktë të planit për përmirësimin e performancës financiare si dhe arritjen e rezultateve pozitive financiare;
- Zhvillimin e TK Sh.A. në një ndërmarrje moderne me afarizem komercial të vetëqendrueshëm dhe me orientim drejt konsumatorit;
- Menaxhimin e vazhdueshëm të ndryshimeve progresive, me qëllim ngritjen e performancës së ndërmarrjes në përputhje me ligjet në fuqi dhe vendimet perkatëse të Qeverisë;
- Sigurimin e zhvillimit adekuat të brendshëm dhe kontrollin e sistemeve dhe procedurave në të gjitha njësitet e biznesit të TK Sh. A të cilat përfshijnë telefoninë mobile dhe telefoninë fikse, shërbimet e internetit si dhe shërbimet e IPTV-së;
- Optimizimin e proceseve afariste në tërësi të ndërmarrjes në pajtim me standartet ndërkombëtare për korporata të këtij lloji.

KE ka përgjegjësi të plotë për:

- Ofrimin e lidershit dhe udhëzimet në formulimin dhe implementimin e strategjive të biznesit, kulturës organizative për të arritur vizionin e TK Sh. A;
- Vendosjen e një ambienti të biznesit dhe të etikës që ndihmon për të ndërtuar kapacitetet e brendshme;
- Inicimin dhe zhvillimin e partneriteteve strategjike nga e cila përfiton TK Sh. A. në aspektin e rritjes, pozicionimit në rajon si dhe përfitimeve financiare;
- Drejtimin dhe koordinimin e aktiviteteve të ndërmarrjes për të arritur planet e biznesit, profitin dhe kthimin e kapitalit;
- Përmbyturjen e detyrimeve që burojnë nga traktatet ndërkombëtare, ligjet e Kosovës, licencat e operimeve dhe aktet tjera.
- Zbatimin me përpikëri të vendimeve të Bordit të Drejtorëve të TK Sh.A;
- Përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planeve vjetore të biznesit të TK Sh.A, përfshirë administrimin e buxheteve vjetore për operime, mirëmbajtje, shpenzime, paga dhe shpenzime kapitale;
- Shqyrtimin e performancës dhe pagave të punëtorëve dhe të masave për motivim në punë;
- Zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të TK Sh.A, cmërimin dhe shkarkimin e punonjësve, mirë-administrimin e proceseve të prokurimit dhe transaksioneve financiare;
- Perfaqësimin e ndërmarrjes në Kosovë dhe jashtë saj;
- Përgatitjen me cilësi të takimeve të Bordit të Drejtorëve të TK Sh.A;

Kushtet dhe kriteret që KE duhet t'i plotësojë:

- Kandidati duhet të ketë diplomë në lëminë e menaxhmentit, ekonomisë, financave, shkencave teknike dhe inxhinierisë. Juridik ose fusha të ngjashme. Preferohet edukim i avancuar (master) në sektorin relevant.

Diploma

- nga univeristet jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara.
- Të dëshmojë njohuri të duhura për menaxhimin strategjik dhe qeverisjen korporative të ndërmarrjes.
- Të jetë në gjendje të ofroj alternativë për arritjen e rezultateve afariste pozitive të ndërmarrjes dhe të menaxhij ndryshimit për arritjen e rezultateve pozitive konform vendimeve të qeverisë, bordit të drejtorëve dhe ligjeve në fuqi.
- Njohuri të mirë produkteve dhe shërbimeve të Telekomit si dhe trendet e zhvillimit të Telekomit.
- Njohuri financiare, me aftësinë për të kuptuar dhe interpretuar të dhënat financiare për vendim marrje.
- Zotësi për tu përshtatur në situata të pa-planifikuar, apo të ndryshuar, fleksibilitet të planeve dhe masat për tu përballur me rrethanat të tilla.
- Zotësi të delegimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara.
- Aftësi për udhëheqje për arritjen e objektivave të përgjithshme të TK Sh.A., si dhe aftësia për të marrë vendime të rëndësishme në situata të vështira;
- Aftësi për implementimin e ndryshimeve të nevojshme dhe aplikimin e metodave të reja afariste për përballimin e sfidave të reja;
- Aftësi për komunikim efikas me shkrim dhe me gojë me Bordin e Drejtorëve, me ndërmarrjet e vet, me konsumatorët, me palet e interesuara, me zyrtarët qeveritar, me media dhe me palet tjera.
- Aftësi për fokusim në çështjet, pritshmerinë dhe problemet e konsumatorëve në mënyrë që ata të kenë përfitime dhe shërbime cilësore në afat të gjatë.
- Vendosmeri në zbatimin e masave disiplinore për drejtues e punonjës në përputhje me ligjin dhe procedurat e TK.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur.

Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë nivel të menaxhmentit të lartë. Preferohen individët me përvojë punë në ndërmarrjet korporata tjera me madhësi dhe kompleksitet të lartë, duke përfshirë dhe kërkesat tjera që i parashihen nën 17. pika 3 e ligjit 03/L-087, s'i është ndryshuar e plotësuar më vonë.

Aplikacionet duhet të dërgohen të shkruara në njërin prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës dhe mund të merren online në www.kosovotelecom.com. Kërkesa për punësim se bashku me CV të detajuar, letër motivuese, dëshminë për punësim dhe kualifikimet dhe çertifikatën nga gjykata kompetente për mosqenic nën hetime jo me vjetër se 6 muaj duhet të dorëzohen personalisht në zyrën e mbyllur në zyrën e arkives qendrore katë VI, zyra nr.611 Ndërcesa Kryesore e TK Dardania pa nr. 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Deklarata nën Betim nënshkruhet në momentin e dorëzimit të aplikacionit. Letër-Referencat nuk kërkohet të dorëzohen në këtë fazë.

Kandidatet me dokumentacion të mangët, të paplotësuar dhe jo adekuat do të refuzohen.



Na osnove člana 21. Zakona o javnim preduzećima, a u vezi sa članom 17. (Zakon br.03/L-087, od 13.06.2008.g. izmenjenog i dopunjenog Zakonom br.04/L-111, od 20.04.2012.g. (u daljem tekstu: Zakon br. 03/L-087) i Odluku od 14.01.2019.g. Odbor direktora TK-a a.d. raspisuje:

KONKURS ZA RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: **Izvršni direktor**
Mesto: Priština
Preduzeće: Telekom Kosova a.d.
Zadnji rok za prijavlivanje na konkursu: 16.02.2019.g. do 16.00 časova

OPIS PREDUZEĆA

Telekomi Kosova a.d. (TK) je javno preduzeće licencirano za pružanje usluga i proizvoda telekomunikacije na otvorenom tržištu, donoseći inovacije i novine na tom tržištu. TK želi popuniti položaj izvršnog direktora sa kandidatom koji ili koja ima potrebnu kvalifikaciju, integritet i potrebno stručno iskustvo, kako bi rukovodio preduzećem, u skladu sa poznatim načelima za korporativno upravljanje javnim preduzećima i da nastavi sa razvojem usluga i proizvoda korporacije.

Naziv radnog mesta: Izvršni direktor

Izvršni direktor (ID), uz izveštavanje Odbora direktora, upravlja svim aktivnostima TK a.d. tako što neposredno koordinira i nadzire rad direktora departmana i ispunjava svoje svakodnevne zadatke u skladu sa Zakonom o javnim preduzećima, matricom za upravljanje, pravilnicima i odlukama Odbora.

Izvršni direktor (ID), treba da ispuni uslove za kvalifikaciju i nezavisnost, shodno članu 21. a u vezi sa članom 17. Zakona 03/L-087, koji je naknadno izmenjen i dopunjen.

Zadaci, odgovornosti i nadležnosti izvršnog direktora su:

- Strateški razvoj TK-a a.d. i korporativno upravljanje preduzećem, putem kvalitetnih i bitnih izmena za uspešno poslovanje istog;
- Razvoj i dosledno sprovođenje plana za poboljšanje finansijskog poslovanja kao i postizanje pozitivnog finansijskog rezultata;
- Razvoj TK-a a.d. u moderno preduzeće sa komercijalnim samoodrživim poslovanjem koje je okrenuto ka korisniku;
- Kontinuirano upravljanje sa progresivnim izmenama, u cilju povećanja radnog učinka preduzeća, u skladu sa zakonima na snazi i odgovarajućim odlukama Vlade.
- Obezbeđenje adekvatnog unutrašnjeg razvoja i kontrole sistema i postupaka u svim odeljenjima poslovanjima TK a.d. koja obuhvaćaju mobilnu telefoniju i fiksnu telefoniju, usluge interneta kao i usluge IPTV-a;
- Optimizaciji poslovnih procesa u celom preduzeću, u skladu sa međunarodnim standardima za ovu vrstu korporacije.

ID ima punu odgovornost za:

- Liderstvo i davanje uputstva za formulisanje i sprovođenje poslovnih strategija poslovanja, organizacione kulture, radi ostvarenja vizije TK a.d.;
- Postavljanje poslovnog ambijenta i etike kako bi se pomoglo izgradnji unutrašnjih kapaciteta;
- Pokretanje i razvoj strateškog partnerstva od kojeg će pridoneti TK a.d. u smislu povećanja, pozicioniranja u regionu kao i ostvarenja finansijske dobiti;
- Upravljanje i koordinaciju aktivnostima preduzeća, radi ostvarenja poslovnih planova, dobitka i povraćaja kapitala;
- Ispunjavanje obaveza koja proizlaze iz međunarodnih sporazuma, zakona Kosova, licenci za rad i iz drugih akata.
- Dosledno ispunjavanje odluka Odbora direktora TK-a a.d.;
- Izradu i nadzor sprovođenja godišnjih poslovnih planova TK-a a.d. uključujući upravljanje godišnjim budžetima za rad, održavanje, troškove (izdatke), plate i kapitalne troškove;
- Razmatranje radnog učinka i plata radnika i mera za njihovo motivisanje za rad;
- Razvoj ljudskih kapaciteta u TK a.d. imenovanje i raskid radnog ugovora radnika, dobro upravljanje postupcima javne nabavke i finansijskih transakcija;
- Predstavljanje preduzeća na Kosovu i vani;
- Kvalitetnu organizaciju sastanaka Odbora direktora TK-a a.d.;

Uslovi i kriterijumi koje ID treba da ispuni:

- Kandidat treba da ima univerzitetsku diplomu u polju upravljanja, ekonomije, finansija, tehničkih nauka i inženjerije, prava ili sličnih polja. Poželjno je da ima unapredeno obrazovanje (magistar) u relevantnom sektoru. Diplome stranih univerziteta treba da budu nostrifikovane.
- Da poseduje potrebno dokazano znanje za strateško i korporativno upravljanje preduzećem.
- Da bude u stanju da pruži alternativna rešenja za postizanje pozitivnog poslovnog rezultata preduzeća i da upravlja sa izmenama, radi postizanja pozitivnih rezultata, shodno odlukama Vlade, Odboru direktora i zakonima na snazi.
- Da poseduje dobro znanje o proizvodima i uslugama Telekoma kao i o trendovima razvoja Telekoma.
- Poseduje znanje o finansijama i sposobnost da shvati i daje komentare o finansijskim podacima, radi donošenja odluka;
- Sposobnost prilagodavanja u neplaniranim ili promenjenim situacijama, fleksibilnost u planiranju i predizimanju mera radi suočavanja i prebrodivanja sličnih situacija.
- Sposobnost delegiranja nadležnosti na saradnike, radi izvršenja delegiranih funkcija.
- Sposobnost za upravljanje i postizanje opštih ciljeva TK a.d. kao i sposobnost za donošenje važnih odluka u teškim situacijama;
- Sposobnost za sprovođenje potrebnih izmena i primenu novih poslovnih metoda kako bi se prebrodili novi izazovi;
- Sposobnost za efikasno pismeno ili usmeno opštenje sa Odborom direktora, njegovim ili njenim potčinjenima, potrošačima, zainteresovanim stranama, državnim službenicima, medijima i sa drugim strankama
- Sposobnost usredsređivanja na pitanja, očekivanja i probleme korisnika, kako bi oni dugoročno pridobili od kvalitetnih usluga;
- Odlucnost u sprovođenju disciplinskih mera za rukovodioce i zaposlene u skladu sa zakonom i procedurama TK.
- Dobro poznavanje engleskog jezika, usmeno i pismeno;

Kandidat treba da ima najmanje 5 godina radnog iskustva na nivou uvek upravljanja. Poželjni su kandidati sa radnim iskustvom u stečenim u velikim i složenim korporacijama, uključujući i ostale zahteve predviđene članom 17. tačka 3, Zakona 03/L-087, koji je naknadno izmenjen i dopunjen.

Prijave za konkurs treba popuniti na jednom od službenih jezika Republike Kosova i mogu se naći na internet stranici www.kosovotelecom.com. Prijava na konkursu zajedno sa detaljnom poslovnim biografijom (CV), motivaciono pismo, dokaz o zaposlenju i kvalifikacije i potvrda od nadležnog suda da nije pod istragom, ne starija od 6 meseci, treba lično podneti (u zatvorenoj koverti) u Kancelariji centralne arhive, VI. sprat, br.611, Glavno sedište TK-a, Dardania bb, 10 000 Priština, Republika Kosova.

Izjava pod zakletvom se potpisuje prilikom podnošenja prijave na konkursu. U ovoj fazi, nije potrebno priložiti preporuke. Kandidati sa nekompletnom dokumentacijom ili sa nepopunjenom prijavom biće odbijeni.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Direkcija za Obrazovanje / Department of Education

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, nenit 18, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 2 paragrafi 7 të Udhëzimit administrativ të MASHT nr. 08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së Drejtorit dhe Zv.drejtorit të institucionit edukativo- arsimor dhe aftësues, Komuna e Skenderajt, shpall këtë:

Nr. 639/2019
Dt. 18 janar 2019

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

I. Titulli i vendit të punës: **Drejtor i shkollës fillore të mesme të ulët (shfmu) dhe mesme të lartë (shml):**

1. Shfmu „ Ahmet Delia“ – Skenderaj
